

MENDIM PAKICE

Unë, anëtarja e trupit gjykues Etleda Çiftja, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri.

Në mbështetje të qëndrimit kundër po argumentoj në vijim arsyet mbi të cilat në përfundim më kanë çuar në vlerësimin se subjektit të rivlerësimit duhet t'i ishte dhënë masa e shkarkimit nga detyra, për arsyet e mëposhtme:

Lidhur me kontrollin e pasurisë

1. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe ndërtimore 83.88 m², i ndodhur në Fier, kam ndarë qëndrim ndryshe nga shumica e trupit gjykues, për sa i përket vlerësimit të çështjeve që kanë të bëjnë me:

- i. Mjaftueshmërinë nga burime të ligjshme të të ardhurave të dhuruesit, personit tjetër të lidhur/z. T. M., në prill të vitit 2011, për t'i dhuruar subjektit shumën 1.260.000 lekë për pagesën e këstit të parë të apartamentit në Fier.
- ii. Mjaftueshmëria nga burime të ligjshme e personit tjetër të lidhur/z. M. M. në shumën 1.000.000 lekë, në qershor të vitit 2011, për t'i dhuruar subjektit shumën 1.000.000 lekë për pagesën e këstit të parë të apartamentit në Fier.

2. Lidhur me çështjen e parë për shumën 1,260,000 lekë, dhuruar nga z. T. M., për pagesën e këstit të parë në datën 24.6.2011, subjekti i rivlerësimit, bazuar në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, kishte detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për dhurimin e bërë nga personi tjetër i lidhur/z. T. M. Të ardhura të ligjshme janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”, sipas përcaktimeve të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

3. Referuar dispozitës më lart, në rastin konkret, personi tjetër i lidhur/babai i bashkëshortit, z. T. M., nuk arriti të provojë të ardhurat e ligjshme, të mjaftueshme për t'i dhuruar shumën 1.260.000 lekë në prill të vitit 2011¹ subjektit të rivlerësimit për blerjen e këtij apartamenti në Fier, si pjesë e pagesës së këstit të parë, pasi nga analiza financiare për personin tjetër të lidhur/z. T. M., duke marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme, sipas kërkesave të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në raport me pasuritë e krijuara, kryerjen e investimeve² dhe pagimin e detyrimeve në momentin e dhënies së shumës hua prej 1.250.000 lekësh, rezultoi se ai nuk kishte mundësi t'ia dhuronte subjektit këtë shumë që ka shërbyer për pagimin e këstit të parë të apartamentit, duke pasur parasysh edhe faktin se në analizë financiare nuk është përfshirë vlera e investimeve, kryer në objektin 4 kate në M., Fier, e dhuruesit T. M.

¹Sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 13.9.2012, nënshkruar nga z. T. M., ku deklaroi se në prill të vitit 2011 i ka dhuruar djalit të tij shumën 1.260.000 lekë, me qëllim plotësimin e vlerës që i nevojitet për blerjen e apartamentit të ndodhur në lagjen “***”, Fier.

²Pa përfshirë këtu investimin në godinën 4-katëshe në M., Fier, të cilën subjekti për disa vite e ka deklaruar si adresë banimi.

4. Pretendimi i subjektit që të hiqet investimi i kryer në shoqërinë “****” në vitin 2004 dhe të merreshin në konsideratë të ardhurat nga punësimi pas vitit 2004 dhe të ardhurat nga aktiviteti blegtoral për periudhën 2008 – 2010, nuk qëndron, për aq kohë sa vetë subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting 2017* se si burim krijimi të të ardhurave nga vjehri janë të ardhura të tij si kursime familjare dhe nga emigracioni nga viti 1992 – 1998 në shtetin grek. Po ashtu të ardhura edhe nga punësimi në blegtori në rrethin e Gjirokastrës e në transportin e udhëtarëve, për më tepër që ky pretendim i subjektit është ndryshe nga deklarimi në deklaratën *Vetting* pas kalimit të barrës së provës dhe evidentimit të situatës financiare të personit tjetër të lidhur, për aq kohë sa subjekti deklaroi se si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat e viteve 1992 – 1998 në shtetin grek. Po ashtu të ardhura edhe nga punësimi në blegtori në rrethin e Gjirokastrës e në transportin e udhëtarëve dhe deklaroi vetë që këto të ardhura janë informale, atëherë nuk ka se si të legjitimohen këto të ardhura nga shumica e trupit gjykues vetëm duke hequr investimet e kryera nga personi tjetër i lidhur në shoqërinë “****” në vitin 2004.

5. Në vlerësim të sa më lart, unë si anëtar në pakicë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë burim krijimi dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.

6. Lidhur me çështjen e dytë, që i përket shumës 1.000.000 lekë, të dhuruar nga personi tjetër i lidhur/z. M. M., në prill të vitit 2011³, për pagimin e kështit të parë të apartamentit, unë vlerësoj se përveç pagave të personit tjetër të lidhur duhen përfshirë edhe investimet me qëllim që të analizohet nëse personat e tjerë kanë pasur apo jo mundësi të krijimit të kësaj shume të dhuruar. Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti deklaroi se ky dhurim është nga të ardhurat nga paga e vëllait të bashkëshortit, z. M. M. dhe për të justifikuar këtë dhurim pa paraqitur kontratën e shitjes së kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k.

7. Nga hetimi administrativ kryesisht gjatë rezultateve të hetimit, rezultoi se personi tjetër i lidhur nuk kishte mundësi nga të ardhura të ligjshme për dhurimin e shumës 1.000.000 lekë në prill të vitit 2011, sipas deklaratës noteriale, duke marrë në konsideratë investimet e kryera në shoqëri të ndryshme⁴ të personit tjetër të lidhur. Nuk jam dakord me shumicën për kufizimin e analizimit të pasurisë së personave të tjerë të lidhur vetëm në masën e të ardhurave, pa përfshirë investimet, detyrimet dhe shpenzimet e tjera që mund të jenë kryer nga dhuruesit.

8. Në përfundim, unë si anëtar në pakicë dal në përfundimin se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur mundësi nga burime të ligjshme për dhënien hua të shumës 1.000.000 lekë në prill të vitit 2011, sipas deklaratës të subjektit në deklaratën *Vetting*.

9. Në vlerësim të konkluzioneve të mësipërme për kriterin e pasurisë, unë si anëtar në pakicë çmoj se kjo pamundësi nuk është e mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit dhe nuk janë të mjaftueshme e proporcionale me vendosjen e masës disiplinore të

³Deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.7.2012, nga z. M. M., i cili deklaroi se i ka dhuruar pa kundërshpërblim vëllait të tij E. M. shumën 1.000.000 lekë në prill të vitit 2011, jashtë zyrës noteriale, me qëllim blerjen e një apartamenti në qytetin e Fierit. Të ardhurat kanë si burim biznesin e z. M. M..

⁴Referohuni rezultateve të hetimit kryesisht.

shkarkimit në raport me kontrollin e këtij kriteri. Në këto kushte, çmoj se këto dy çështje së bashku, ndonëse nuk mjaftojnë për të arritur në konkluzionin e mësipërm si një shkak më vete shkarkimi, ato duhet të merren në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit, sipas pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

10. Objekt i kontrollit të figurës, sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, është *verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.*

11. Sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, *“kontakt i papërshtatshëm” është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni ose ndonjë marrëdhënie tjetër.*

12. Më tej, referuar pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, *“person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10/192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastiit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.*

13. Sipas nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen kontrollit të figurës, me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja. Deklarata mbulon periudhën nga data 1.1.2012 deri në ditën deklarimit, sipas ligjit.

14. Në pikat 3 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, përcaktohet se: *“3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. 4. [...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.*

15. Në rezultatet e hetimit kryesisht, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për mosdeklarimin nga ana e saj në formularin e DSIK-së të një kontakti të papërshtatshëm të vitit 2012.

16. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur kontakt të papërshtatshëm si pasojë e një marrëdhënieje kontraktore (kontratë shitblerjeje apartamenti) në vitin 2012 me shtetasin V. Z., tek i cili bashkëshorti i subjektit ka blerë apartamentin me sip. 95 m² në Fier. Sipas germës “c” të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet se c) *subjekti*

i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar, rrethanë e cila merret parasysh se ekziston kontakti i papërshtatshëm. Këtë fakt e ka përforcuar vetë subjekti, e cila, në përgjigje të pyetësorit, ka deklaruar se ky shtetas kishte procedim të regjistruar në vitin 2015 në Prokurorinë e Rrethit Fier dhe subjekti i rivlerësimit ka dhënë dorëheqjen, duke pretenduar se me këtë shtetas ka marrëdhënie kontraktore për shkak të blerjes së apartamentit në Fier. Kjo kërkesë e subjektit ka bindur edhe Drejtuesin e Prokurorisë, i cili ka pranuar dorëheqjen e subjektit.

17. Sipas vlerësimit tim, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës se duhet të kishte deklaruar kontaktin me këtë shtetas në formularin e deklarimit të kontrollit të figurës.

18. Më tej, nga analizimi i kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit rezulton se subjekti dhe personi i lidhur kanë lidhje familjare, marrëdhënie dhurimi, punësimi dhe biznesi me shtetasit S. G., M. M., A. M. dhe K. Z.

19. Nga analizimi i këtyre marrëdhënieve për efekt të kriterit të kontrollit të figurës, rezultoi se: (i) shtetasit S. G. dhe M. M. janë persona të tjerë të lidhur me subjektin, sipas nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, pasi kanë qenë kontribuues në të ardhurat që kanë shërbyer për dhurimin e shumës 1.000.000 lekë për blerjen e apartamentit në Fier në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj; (ii) shtetasit S. G., M. M. dhe bashkëshorti i subjektit, z. E. M., kanë bashkëthemeluar dhe bashkadministruar disa shoqëri gjatë viteve 2003 – 2012 (si: “****” sh.a., “****” sh.a., “****” sh.p.k.); (iii) përveç angazhimit të hershëm, të ngushtë e të vazhdueshëm me personat dhe shoqëritë e përmendura më lart në aktivitete biznesi, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë përdorur automjetet e shtetasve A. M. dhe K. Z. gjatë 2019 - 2020, përkatësisht automjetin me targa *** në pronësi të shtetasit A. M. në datën 23.1.2019 dhe automjetin me targa *** në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., në datën 27.12.2020⁵; (iv) sipas të dhënave nga sistemi TIMS rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë përdorur për udhëtime jashtë vendit automjetet me targa *** dhe ***; (v) punësimi i personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit që prej vitit 2018 deri në maj të vitit 2022 nga shoqëria “****” sh.p.k., në një pozicion të rëndësishëm, kjo e fundit kishte lidhje të ngushtë dhe aktive me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe me shtetasin K. Z. (partner aktiv, përfaqësues i..., shoqëri zbatuese/nënkontraktore e...) etj. Këto rrethana tregojnë se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë kontakte të vazhdueshme në formën e takimit, udhëtimit, familjes, biznesit etj. me këta shtetas, të cilët janë proceduar penalisht për vepra penale të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe, për rrjedhojë, për efekt të ligjit nr. 84/2016 konsiderohen kontakte të papërshtatshme.

20. Sipas vlerësimit tim, subjekti i rivlerësimit nuk provoi dot të kundërtën e barrës së provës se së bashku me personin e lidhur kanë kontakte të papërshtatshme faktike me persona të cilët aktualisht janë proceduar penalisht për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe

⁵Shihni të dhënat nga sistemi TIMS në dosjen hetimore të Komisionit.

korruptionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar dhe, si të tillë, konsiderohen persona të përfshirë në krimin e organizuar.

21. Në vlerësim të konkluzioneve të mësipërme për kriterin e figurës, unë si anëtar në pakicë çmoj se problematikat e adresuara më lart në lidhje me kriterin e figurës nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti ka probleme serioze me kontrollin e figurës, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk janë të mjaftueshme e proporcionale me vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit në raport me kontrollin e këtij kriteri. Në këto kushte, çmoj se këto problematika të evidentuara më lart, ndonëse nuk mjaftojnë për të arritur në konkluzionin e mësipërm si një shkak më vete shkarkimi, ato duhet të merren në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit, sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me kontrollin e aftësive profesionale

22. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 se për këstin e dytë të pagimit të apartamentit në Fier me sip. 95 m² ka shërbyer një kredi në shumën 2.240.000 lekë, likuiduar në datën 2.8.2011 në Bankën Kombëtare Tregtare, dega Fier.

23. Nga hetimi i Komisionit rezultoi e provuar se kjo kredi në shumën 2.240.000 lekë, përfituar nga subjekti i rivlerësimit me kushte lehtësuese si e pastrehë, nga Këshilli Bashkiak Fier⁶, me interes në masën 3%, të subvencionuar, për blerje banese me kosto të ulët, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9232/2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

24. Në analizimin e këtij burimi krijimi, unë vlerësoj se është e rëndësishme të analizohet: (i) mënyra e përfitimit të kredisë me kushtet lehtësuese sipas kërkesave të ligjit nr. 9232/2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, sipas të cilit këto kredi përfitohen nga kategori të veçanta vulnerabël (shihni nenet 5 dhe 196 të ligjit) dhe me nivel të ulët të të ardhurave familjare (si ato të konsideruara nga Bashkia Fier në disa raste në vitin 2011); (ii) nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur në hetim ndonjë çështje penale që lidhet me Bashkinë Fier në momentin e marrjes së kredisë me kushte lehtësuese me normë interesi 3%, por dhe më tej gjatë zbatimit të kontratës së kredisë, e cila vazhdon për një periudhë 20-vjeçare nga momenti i nënshkrimit të kontratës në gusht të vitit 2011.

25. Lidhur me çështjen e parë mbi mënyrën e përfitimit, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, konkretisht Bashkia Fier, rezulton se paga e marrë nga subjekti i rivlerësimit është në shumën 100.000 - 120.000 lekë/muaj së bashku me bashkëshortin 73.000 lekë/muaj. Këto të ardhura të deklaruara janë relativisht të larta krahasuar me të ardhurat e familjeve të tjera përfituese të kredisë lehtësuese për banesa sociale, të cilat janë 40.000 - 65.000 lekë/muaj të ardhura familjare sipas vlerësimit të Këshillit Bashkiak në korrik të vitit 2011. Pra, bazuar në këto të ardhura, subjekti nuk kategorizohet si familje e cila duhet të përfitonte këtë kredi për banesë sociale me kushte

⁶Vendim nr. ***, datë 1.7.2010, i Këshillit Bashkiak Fier, për ndryshimin e një vendimi të mëparshëm nr. ***, datë 30.10.2009, duke: (i) zëvendësuar listën e përfituesve me një tjetër; dhe (ii) shtuar një listë tjetër familjesh në pritje të marrjes së një kredie të butë, duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit.

lehtësuese, sipas kërkesave të ligjit nr. 9232/2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

26. Lidhur me çështjen e dytë të konfliktit të interesit midis atij privat të subjektit në përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, në kushtet kur subjekti nuk mund të kategorizohet si familje përfituese dhe detyrë publike që subjekti ka ushtruar si prokurore, unë si anëtar në pakicë vlerësoj se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës si prokurore, për shkak se nga procesi i rivlerësimit rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pushuar dhe mosfilluar procedime penale në ngarkim të Bashkisë Fier, ndërkohë që duhet të kishte dhënë dorëheqjen, si vijon: (i) në datën 19.12.2011 subjekti i rivlerësimit ka pushuar procedimin penal nr. ***, filluar pas kallëzimit penal të kryetarit të Bashkisë Fier, bazuar në dyshimet për shpërdorim detyre nga disa këshilltarë bashkiakë, duke thirrur një mbledhje dhe kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin; (ii) subjekti i rivlerësimit ka mosfilluar procedimin nr. *** regjistrimi, datë 18.4.2013, iniciuar nga kallëzimi i Sektorit kundër Krimit Financiar Fier mbi: (1) dyshime për veprime të paligjshme nga zyrtarë publikë të Bashkisë Fier në kuadër të projektit për ndërtimin e Pallatit të Sportit gjatë viteve 2011 - 2012; dhe (2) për përdorimin e fondeve nga bashkia gjatë viteve 2011 - 2012, pa verifikuar më parë rrethanat e parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale të kohës; (iii) kallëzimi penal nr. *** – në datën 26.5.2014 subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për akuzat “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim të dokumenteve”, lidhur me lejen e ndërtimit (nr. ***) dhe lejen e sheshndërtimit (nr. ***), lëshuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Fier, në favor të një kompanie ndërtimi; (iv) kallëzimi penal nr.***– subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim për mosfillim të procedimit penal në datën 5.6.2012 ndaj kryetarit të Bashkisë Fier për “shpërdorim detyre” dhe “shkatërrim prone”.

27. Në përfundim të analizimit të interesit privat të marrjes së kredisë me kushte lehtësuese, në rastin e mosplotësimit të kriterëve në raport me çështjet penale të pushuara dhe mosfilluara nga ana e subjektit si prokurore, unë si anëtar në pakicë vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në marrjen e vendimeve lidhur me këto procedime penale, ku evidentohet se vetëm në një rast ka kërkuar dorëheqjen nga çështja, duke u gjendur në kushtet e pikës 4 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

28. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka qenë prokurore e cila ka hetuar procedimet penale nr. *** dhe nr. *** ndaj shoqërisë “****” sh.a., ndërkohë që bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie për periudhën tetor 2013 – 2019. Unë si anëtar në pakicë vlerësoj se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte kërkuar dorëheqjen nga hetimi i këtyre dy procedimeve, për aq kohë sa bashkëshorti i saj ishte i punësuar në shoqërinë “****” sh.a., duke u gjendur në kushtet e pikës 4 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

29. Lidhur me mosfillimin e procedimit nr. *** ndaj gjyqtarit A. B., për të cilin subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës se *subjekti nuk ka kryer verifikime dhe hetime lidhur me këtë kallëzim dhe mungesën e arsytimit të duhur për mosfillimin e procedimit*, unë si anëtar në pakicë nuk e gjej të mbështetur në Kodin e Procedurës Penale arsytimin e subjektit se mungesa e një

kallëzimi nga ana e Komisionit nuk e mundëson fillimin e hetimeve për këtë çështje. Referuar nenit 283 të Kodit Penal “Kallëzimi nga ana e shtetasve”, që parashikon se *çdo person që ka marrë dajeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë*, duke çuar kështu në një mungesë të pajustificuar dhe të paligjshme të vendimit të mosfillimit të hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke u gjendur në kushtet e pikave 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

30. Në vlerësim të konkluzioneve të mësipërme për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, unë si anëtar në pakicë çmoj se mangësitë e vërejtura në çështjet e mësipërme, përfshirë trajtimin jo me mënyrën e duhur të situatave të konfliktit të interesit në 6 raste dhe të një çështjeje, e cila nuk është hetuar nga subjekti me argumentin se nuk është kallëzuar nga organi i duhur, konsiderohen se janë qëndrime që kanë afektuar indikatorët e njohurive të ligjit, etikës dhe integritetit, të parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3 dhe nenin 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, situatë e cila kualifikohet si nivel “me mangësi” i kriterit të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 44, pika “b” e ligjit nr. 84/2016.

31. Gjithsesi, këto defekte në kriterin e aftësive profesionale nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale dhe nuk janë të mjaftueshme e proporcionale me vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit në raport me kontrollin e kriterit profesional. Në këto kushte, çmoj se probleme të konstatuara në vlerësimin profesional, ndonëse nuk mjaftojnë për të arritur në konkluzionin e mësipërm si një shkak më vete shkarkimi, ato duhet të merren në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit.

32. **Si përfundim**, nga vlerësimi tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, unë si anëtar në pakicë vlerësoj se subjekti i rivlerësimit dështoi të kalonte testin e moscenimit të besimit të publikut, për shkak të ekzistencës së të gjitha këtyre problematikave që rezultuan në të tria kriteret e rivlerësimit dhe se programi i trajnimit njëvjeçar në Shkollën e Magjistraturës nuk mund të shërojë këtë situatë në drejtim të rikuperimit të besimit të publikut. Për rrjedhojë, vlerësoj se shumica nuk duhet të kishte disponuar konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, por shkarkimin e saj nga detyra, sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Anëtare/kundër
Etleda ÇIFTJA**